



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI**

UDHËZIM

Nr 04, datë 04.02.2011

PËR

PROCEDURAT E PLOTËSIMIT DHE MËNYRËN E QARKULLIMIT TË DOKUMENTEVE ADMINISTRATIVE PËR VJETËRSIN NË SHËRBIM, PAGËN REFERUESE NETO E MESATARE REFERUESE NETO TË PËRFITUESVE NGA SIGURIMET SHOQËRORE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE.

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 19 të Ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nenit 128, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të Kreut VIII, të Vendimit Nr. 793, datë 24.9.2010 të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e Ligjit Nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

U D H Ë Z O J :

I. Sektori Informacionit dhe Pritjes së Publikut në Drejtorinë e Administrimit të Shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve në Rezervë, Pension dhe Veteranëve në Drejtorinë e Përkujdesjes Sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes, Komanda e Brigadës së Mbrojtjes Rajonale, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes, komandat (drejtoritë) e njërive e reparteve apo drejtoritë e institucioneve ushtarake në vartësi të drejtpërdrejtë të MM dhe SHPFA, të gjitha kategoritë e përfituesve, të cilëve u lind e drejta për përfitime sipas ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009,

fillimisht i drejtojnë (udhëzojnë) të paraqiten në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore(DRSSH) ku kanë vendbanimin e përhershëm, për plotësimin e kërkesës personale dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshme që nevojitet për fillimin e procedurave për përfitim e pensioneve suplementare.

II. Paraqitja e kërkesës dhe qarkullimi i dokumentacioni për fillimin e procedurave për përfitim .

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS), Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinave dhe Stervitjes, Komanda e Brigadës Mbrojtjes Rajonale, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes dhe komandat e njësive e reparteve apo drejtoritë e institucioneve ushtarake në vartësi të drejtpërdrejtë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA, pranojnë me postë zyrtare ose dorëzimin direkt të kopjes së dytë të kërkesës format (modularin nr.01) të plotësuar në DRSSH dhe dokumentat e tjera shoqëruese dhe identifikuese, të personit që e drejta për përfitim sipas ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009 i ndryshuar, i ka lindur përpara dhe pas hyrjes në fuqi të tij, dhe që aplikojnë për herë të parë, për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, për pension pleqërie, për pension suplementar mbi pensionin e plotë të pleqërisë, për pension suplementar invaliditeti, familja e ushtarakut për pension suplementar familjar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS), për ushtarakun në pension të plotë pleqërie, që ka ndërprerë karrierën përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 7496, date 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura” dhe që aplikon në DRSSH për të përfutur pension suplementar, kopjen e dytë të kërkesës format të plotësuar dhe fotokopjen e formularit të vjetërsisë së shërbimit, nxjerrë nga dosja e pensionit që ndodhet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, e merr nga kjo e fundit, me postë zyrtare, për procedurë të mëtejshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS) në Ministrinë e Mbrojtjes, për ushtarakun dhe familjen e ushtarakut, që trajtohet me një nga llojet e pensioneve suplementare, që janë caktuar sipas Ligjit Nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe kërkon në DRSSH të ri-llogarisë përfitim të pensionit suplementar të fituar më përpara, pret nga DRSSH, me postë, listën emërore të përfutuesve, të shoqëruar me shkresë përcjellëse, për procedurë të mëtejshme.

4. Ushtarakët në pension të trajtuar në reformë me VKM nr. 225, datë 29.05.1992 “ Për trajtim financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”, VKM Nr. 7, datë 10.01.1996 “Për pagesën e ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura” dhe ushtarakët që kanë

fillimisht i drejtojnë (udhëzojnë) të paraqiten në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) ku kanë vendbanimin e përhershëm, për plotësimin e kërkesës personale dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshme që nevojitet për fillimin e procedurave për përfitimin e pensioneve suplementare.

II. Paraqitja e kërkesës dhe qarkullimi i dokumentacioni për fillimin e procedurave për përfitim .

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS), Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinave dhe Stervitjes, Komanda e Brigadës Mbrojtjes Rajonale, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes dhe komandat e njësive e reparteve apo drejtoritë e institucioneve ushtarake në vartësi të drejtpërdrejtë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA, pranojnë me postë zyrtare ose dorëzimin direkt të kopjes së dytë të kërkesës format (modularin nr.01) të plotësuar në DRSSH dhe dokumentat e tjera shoqëruese dhe identifikuese, të personit që e drejta për përfitim sipas ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009 i ndryshuar, i ka lindur përpara dhe pas hyrjes në fuqi të tij, dhe që aplikojnë për herë të parë, për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, për pension pleqërie, për pension suplementar mbi pensionin e plotë të pleqërisë, për pension suplementar invaliditeti, familja e ushtarakut për pension suplementar familjar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS), për ushtarakun në pension të plotë pleqërie, që ka ndërprerë karrierën përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura" dhe që aplikon në DRSSH për të përfituar pension suplementar, kopjen e dytë të kërkesës format të plotësuar dhe fotokopjen e formularit të vjetërsisë së shërbimit, nxjerrë nga dosja e pensionit që ndodhet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, e merr nga kjo e fundit, me postë zyrtare, për procedurë të mëtejshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPS) në Ministrinë e Mbrojtjes, për ushtarakun dhe familjen e ushtarakut, që trajtohet me një nga llojet e pensioneve suplementare, që janë caktuar sipas Ligjit Nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe kërkon në DRSSH të ri-llogarisë përfitimin e pensionit suplementar të fituar më përpara, pret nga DRSSH, me postë, listën emërore të përfituesve, të shoqëruar me shkresë përcjellëse, për procedurë të mëtejshme.

4. Ushtarakët në pension të trajtuar në reformë me VKM nr. 225, datë 29.05.1992 "Për trajtim financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura", VKM Nr. 7, datë 10.01.1996 "Për pagesën e ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura" dhe ushtarakët që kanë

përfituar pensionet e caktuara sipas ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" që kërkojnë ri-llogaritjen të pensionit të pleqërisë në DRSSH, kërkojnë vetë nga Sektori i Shërbimeve të Financës në Drejtorinë e Administrimit të Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes ose nga strukturat e financës së reparti ushtarak ku kanë dalë në rezervë ose lirim, vërtetimin tip për pagën referuese të periudhës së trajtimit me pagesë në reformë sipas VKM nr. 225, datë 29.05.1992, VKM Nr. 7, datë 10.01.1996. Vërtetimi i lëshuar nga këto struktura dërgohet në DRSSH nga vetë personi i interesuar.

III. Procedurat e punës të strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe të strukturave të Forcave të Armatosura.

1. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale (Sektori i Përkujdesjes Sociale për ushtarakët në rezervë, pension dhe veteranëve) në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, është struktura që pret dhe menaxhon përgatitjen përfundimtare të gjithë dekumentacionin të ushtarakut që aplikon për përfitimit të pensionit të pleqërisë apo suplementar i cili ka dalë dhe del në rezervë apo lirim nga drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm. Pas verifikimit të dekumentacionit, të dhënave në dosjen personale të përfituesit, plotëson formularët (modularët) tip, dhe dërgon për procedurë verifikimi dhe nënëshkrimi në Drejtorinë e Drejtorinë e Financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes të modularit Nr.02. Pas përfundimit të kësaj procedure, dekumentacionin e plotë, e dërgon me postë zyrtare, veç e veç e të shoqëruar me shkresë percjellëse, në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku banon ushtaraku apo familja e tij, për procedura të mëtejshme.

2. Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes, Komanda e Brigadës Mbrojtjes Rajonale, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes dhe komandat e njëjseve dhe reparteve në vartësi të tyre, presin të gjitha kërkesat dhe dekumentacionin plotësues për përfitim të pensionit të plotë të pleqërisë apo suplementar, për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën ushtarake në strukturën e tyre organike dhe të atyre ushtarakëve që kanë qenë në repartet e tjera, por që, pas ristrukturimeve, janë suprimuar dhe dekumentacioni ose aktiviteti financiar është thithur nga komanda e forcës, njësisë apo repartit ushtarak që aktualisht funksionon.

3. Komanda e Policisë Ushtarake, Komanda e Qendrës së Personel Rekrutimit, Komanda e Agjencisë Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Drejtoria e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak, Drejtoria e Qendrës së Kulturës, Medies dhe Botimeve të Mbrojtjes, Drejtoria e Institutit të Studimeve e Projektmeve të Mbrojtjes, dhe Drejtoria e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare, presin të gjitha kërkesat dhe dekumentacionin plotësues për përfitim nga sigurimet shoqërore dhe ato suplementare për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën ushtarake në strukturën e tyre organike dhe të atyre ushtarakëve që kanë qenë në

repartet e tjera, por që, pas ristrukturimeve, janë suprimuar dhe dokumentacioni ose aktiviteti financiar është thithur nga komanda e njësisë, repartit apo drejtoritë e institucioneve ushtarake që aktualisht funksionon.

4. Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes, Komanda e Brigadës së Mbrojtjes Rajonale, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes, Komanda e Policisë Ushtarake, Komanda e Qendrës së Personel Rekrutimit, Komanda e Agjencisë Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Drejtoria e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak, Drejtoria e Qendrës së Kulturës, Medies dhe Botimeve të Mbrojtjes, Drejtoria e Institutit të Studimeve e Projektmeve të Mbrojtjes dhe Drejtoria e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare, janë struktura që menaxhojnë përgatitjen përfundimtare të dokumentacionit të ushtarakëve përfitues, sipas Ligjit Nr.10142, datë 15.5.2009 i ndryshuar dhe VKM Nr.793, datë 24.9.2010 në mbështetje të ligjit të mësipërm, të dërguara nga repartet vartëse dhe dërgimin me postë zyrtare, veç e veç e shoqëruar me shkresë përcjellëse, në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku banon ushtaraku apo familja e tij.

5. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale (Sektori i Përkujdesjes Sociale për Ushtarakët në Rezervë, Lirim dhe Veteranët) në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM, është struktura që menaxhon të gjithë dokumentacionin e ardhur nga Instituti Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorit Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dhe dërgimin e tyre në rrugë zyrtare në strukturat e tjera të FA, për procedura të mëtejshme

6. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale (Sektori i Përkujdesjes Sociale për Ushtarakët në Rezervë, Lirim dhe Veteranët) në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM dhe stukturat e personelit në komandat e forcave, njësisë dhe reparteve ushtarake në vartesi të tyre, për plotësimin e dokumentacionit në zbatim të ligjit Nr.10 142, datën 15.5.2009 i ndryshuar dhe ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipëtare" i ndryshuar, kërkojnë nga aplikuesi që bashkë me dorëzimin e dokumentacionit të domosdoshëm të plotësojë edhe 2(dy) kopje format kërkesë (modular tip) drejtuar struktururës përgjegjëse ku deklaron gjeneralitetet dhe sasin e dokumentave që dorezon.

7. Struktura përgjegjëse në MM dhe të gjitha strukturat përgjegjëse të Forcave të Armatosura, në zbatim të ligjit Nr.10 142, datën 15.5.2009 i ndryshuar dhe ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", plotësojnë vërtetime (modularët) si më poshtë:

- a. Vërtetimi për vjetërsin e punës e të shërbimit si ushtarak për efekt të përfitimeve nga sigurimi suplementar(modular nr 04).
- b. Vërtetimi për pagën neto referuese për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare për përfituesit sipas nenit 21, të ligjit nr. 10142, date 15.05.2009 (modular nr.02).

- c. Vërtetim për vjetërsi në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto (modular nr.03).
- d. Vërtetim kronologjik për derdhjen e kontributit suplementare të paguara, sipas muajve e viteve (modelar Nr.05).
- e. Vërtetim për efekt pensioni vjetërsie shërbimi, invaliditeti ose familjar (Modular tip 31).
- f. Vërtetim tip për pagat mesatare të 10 viteve të fundit.
- g. Vërtetim tip për periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare.
- h. Vërtetim drejtuar ISSH për punësimin në strukturat e tyre të ushtarakut në rezervë ose lirim.

8. Komanda e Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), e cila në bazë të urdhrit të MM Nr.390, datë 13.03.2008 "Për kryerjen e shpenzimeve të pagesës kalimtare të ushtarakëve në rezervë apo lirim" kryen pagesën kalimtare, të ushtarakëve në rezervë apo lirim, lëshon Vërtetimin Tip për periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare të gjithë ushtarakëve që përgatitin dokumentat për përfitim të pensionit suplementar të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pension pleqërie. Ky vërtetim dërgohet nga vetë ushtaraku në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për rastet kur plotëson dokumentat për përfitim të pensioni të pleqërie dhe në strukturën e personelit të repartit ushtarak ku ka ndërprerë karrierën ushtarake për rastin e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

9. Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve (Sektori i Shërbimeve të Financës) në Ministrinë e Mbrojtjes, për ushtarakët që kanë dalë në rezervë apo lirim nga drejtoritë e MM dhe SHPFA dhe strukturat e financës në komandat e forcave, komandat e njësisë, reparteve apo drejtorive të institucioneve ushtarake në vartësit të drejtpërdrejtë të MM dhe SHPFA, ushtarakëve që plotësojnë dokumentacionin për përfitime nga sigurimet shoqërore suplementare, që kanë ndërprerë karrierën ushtarake në strukturën e tyre organike dhe të atyre ushtarakëve që kanë qenë në repartet e tjera, por që, pas ristrukturimeve, janë suprimuar dhe dokumentacioni ose aktiviteti financiar është thithur nga komanda e forcës, njësisë apo repartit ushtarak që aktualisht funksionon, u lëshojnë vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve dhe viteve (Modulari nr.05).

10. Strukturat e personelit në MM, SHPFA dhe të Forcave të Armatosura që kanë të punësuar në funksione civile, ushtarak të nxjerrë në rezervë apo lirim dhe që plotësojnë kushtet për përfitim pensioni suplementar të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur këta të fundit e kërkojnë, lëshojnë vërtetim që tregon punësimin ose ndërprerjen e punësimit të tyre. Ky vërtetim dërgohet nga vetë ushtaraku ose me postë nga struktura që e lëshon, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku ka aplikuar kërkuesi.

11. Drejtoria e Administrimit të Shërbimeve (Sektori i Shërbimeve të Financës), për ushtarakët që kanë dalë në rezervë apo lirim nga strukturat e MM dhe SHPFA dhe strukturat e forcave në komandat e forcave, njësisë, reparteve ushtarake, për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën ushtarake në

strukturën e tyre organike dhe të atyre ushtarakëve që kanë qenë në repartet e tjera, por që, pas ristrukturimeve, janë suprimuar dhe dokumentacioni ose aktiviteti financiar është thithur nga komanda e forcës, njësisë apo repartit ushtarak që aktualisht funksionon, për ushtarakët në pension pleqërie që kërkojnë ri-llogaritje të pensionit lëshojnë vërtetim për pagat referuese të trajtimit në reformë me VKM nr. 225, datë 29.05.1992 dhe VKM NR.7, datë 10.01.1996, pensionet e caktuara sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të nxjerra nga listë-pagesat(borderotë) e financave.

12. Strukturat e personelit në komandat e forcave, njësive, reparteve apo institucioneve ushtarake në vartësi të drejtprdrejtë të MM dhe SHPFA, të evidentojnë në regjistër të posaçëm dhe në data-baze të gjithë emrat e ushtarakëve që u lind e drejta dhe u janë derguar dokumentat në DRSSH për përfitim nga sigurimet shoqërore suplementare. Çdo fund muaji këto të dhëna raportohen (dërgohen) në rrugë zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore(DPS).

13. Strukturat që menaxhojnë personelin në MM, SHPFA, në komandat e forcave, njësive, reparteve ushtarake apo institucioneve ushtarake në vartësi të drejtprdrejtë të MM dhe SHPFA, në rastet kur dosja personale e n/oficerit mungon, do të hapin dosje të re me të gjitha dokumenta që kërkohen mbështetur në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes Nr.359, datë 27.05.2004 "Për miratimin e dosjes së ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Në të gjitha rastet kur mungojnë të dhënat dhe dokumentat që vërtetojnë emërimin në detyrë, nxjerrjen në rezervë apo lirim si ushtarak aktivë, do të njohin si dokument ligjor për vjetërsi shërbimi, vetëm vendimin e gjykatës së formës së prerë ku si palë e tretë është (ka qenë reparti) institucioni ushtarak, ku ka shërbyer n/oficeri. Dokumenti i këtij vendimi do jetë origjinal ose i noterizuar dhe ruhet në dosjen personale të n/oficerit.

14. Komandat e forcave, njësive, reparteve apo institucioneve ushtarake në vartësi të drejtprdrejtë të MM dhe SHPFA, në rastet kur mungon dosja personale e oficerit që ka dalë në rezervë, lirim apo pension, do t'i marrin të dhënat në kopjen e parë të dosjes personale që ndodhen në kartotekën e personelit të Qendrës së Personel Rekrutim. Kur në dosjen personale, Arkivin Qendror të FA, mungojnë të dhënat e oficerit për nxjerrjen në rezervë apo lirim, do të njihen të dhënat për vjetërsi shërbimi, vetëm vendimi i gjykatës se formës se prerë.

IV. Llojet e dokumentacionit që dorëzohet nga përfituesi në strukturën përgjegjëse në MM, komandat e forcave, repartet apo institucionet ushtarake në varësi të MM dhe SHPFA sipas llojit të përfitimit.

1. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale (Sektori Përkujdesjes Sociale Ushtarakëve në Rezervë, Pension dhe Veteranë) në MM dhe degët, sektorët, seksionet e personelit në komandat e forcave, njësive, repartin dhe institucioneve ushtarake kërkojnë nga ushtarakët që të dorëzojnë së bashku me 2(dy) fletë

kërkesat(modular tip) që plotësohen drejtuar këtyre strukturave dokumentacionin e mëposhtëm sipas llojit të përfitimit:

a. Për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi:

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore(modular nr. 01);
- fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi;
- vërtetim për periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare, lëshuar nga Qendra e Personel Rekrutimit;
- dëshmi penaliteti lëshuar nga Ministria e Drejtësisë;
- vërtetim për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve e viteve të lëshuar nga degët, sektoret, seksionet e financës së institucionit apo repartit ushtarak.

b. Për të përfituar pension suplementar pleqërie :

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore(modular nr.01);
- fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.

c. Për të përfituar pension suplementar invaliditeti :

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore(modular nr.01);
- fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi;
- kopje ose foto kopje të noterizuar të Vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

d. Për të përfituar pension suplementar familjar:

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore(modular nr.01);
- certifikatë familjare;
- certifikatë vdekjeje të ushtarakut.

e. Për të përfituar pension suplementar familjar, në rastet kur personat kanë humbur jetën në detyrë dhe për shkak të detyrës:

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore(modular nr.01);
- certifikatë familjare;
- certifikatë vdekjeje të ushtarakut.

f. Për pension të plotë pleqërie:

- kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (modular nr.01);
- fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.

V. Procedurat e plotësimit të modularëve, përcaktimit të viteve të shërbimit, të pagës referuese të njësuar dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese mujore neto, për përfitim nga sigurimet shoqërore shtesë.

1. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale (Sektori Përkujdesjes Sociale Ushtarakëve në Rezervë, Pension dhe Veteranë) në MM dhe degët, sektorët, seksionet e personelit dhe financës në komandat e forcave, njësive, reparteve e institucioneve ushtarake, për personat që e drejta për përfitim, sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, u ka lindur përpara dhe pas datës 27.06.2009 date hyrjes në fuqi e këtij ligji dhe që kanë aplikuar në DRSSH, për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pension suplementar invaliditeti, pension suplementar familjar, do plotësojnë dosjen e personit të përfituesit edhe me 2(dy) kopje të modularëve të si më poshtë:

a. Modularin nr. 03 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto". Specialisti për personelin dhe specialisti për financës për plotësimin e tij mbështeten në këto dokumente:

- Modularin Nr. 03/a ose Nr. 03/b "Paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën", që bëjnë specifikimet e karrierës dhe të shtesave mbi pagë.
- Dosjen personale të ushtarakut.
- Urdhrin e MM Nr. 2353, datë 23.12.2010 "Për njësimin e funksioneve ose gradave që nuk ekzistojnë më, me funksionet apo gradat që janë në fuqi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".
- Listat me kodin numerik konvencional të njësive, reparteve e institucioneve ushtarake që janë suprimuar.
- VKM për pagat ushtarakëve aktiv të FA sipas viteve.
- VKM, urdhrat dhe udhëzimet për shtesat për vështirësi vendi dhe Punë, sipas viteve.
- VKM për derdhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet suplementare.
- o Specialisti i personelit: bazuar në dosjen personale të ushtarakut, plotëson pjesën e parë dhe të dytë të modularit nr. 03, me të dhëna për gjeneralitetet e ushtarakut, fillimin e karrierës si ushtarak aktiv, dalje në rezervë ose në lirim;

- Për pjesën e tretë, rreshti I, kolona **b** “Përshkrimi i pozicioneve (detyrave) të karrierës”, plotësohet duke vendosur sipas përshkrimit kronologjik pozicionet (funksionet) e vendit të punës gjatë karrierës për periudhën e vjetërsisë së shërbimit aktiv e njësuar në bazë të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 2353, datë 23.12.2010 “Për njësimin funksioneve ose gradave që nuk ekzistojnë më, me funksionet apo gradat që janë në fuqi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
Kjo do të merret nga të dhënat e kolonave “Emërtimi i repartit”, “Funksioni kronologjik për gjithë karrierën”, “Funksioni apo grada e njësuar” të Modularit Nr. 03/b që bënë specifikimin e njësimit e funksioneve apo gradave që nuk janë më me ato që janë në kohën kur i lind e drejta për përfitim nga sigurimet suplementare.
- Në kolonën **c** “Fillimi”, do të vendoset data e fillimit të punës në atë detyrë apo funksion që është emëruar për herë të parë ose gjatë transferimit të tij në atë detyrë apo funksion.
- Në kolonën **d** “Mbarimi”, do të vendoset data e lënies së detyrës në atë funksion ose gradë dhe emërimi ose transferimi në një detyrë apo funksion tjetër, deri në lënien e karrierës ushtarake.
- Në kolonën **e** “Ditë grade apo funksioni”, do të vendoset sasia e ditëve që është në atë gradë apo funksion që del si difference midis kolonës (c-d). Për këtë viti do të llogaritet me 365 ditë dhe muaji me 30 ditë.
- Në pjesën e tretë, në rreshtin II “Ndërprerje” shënohet (vendoset) koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të një urdhri apo vendimi të padrejtë, të deklaruar me vendim gjykatë.
- Në rreshtin III “Dënim politik”, shënohet (vendoset) dhe koha e plote e vuajtjes së dënimit me burgim apo internimit pas titullimit në karrierë kur ushtaraku ka përfituar sipas ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politik vërtetuar me dëshmi penaliteti nga Ministria e Drejtësisë dhe vërtetim nga Ministria e Brendshme.
- Në rreshtin IV “1.5 fish” shënohen (plotësohen) funksionet organike me specifikë të veçantë ku vjetërsia e shërbimit merret me 1.5- fish, të cilat janë përcaktuar nga VKM nr. 793, datë 24.09.2010, dhe llogaritet në bazë të periudhës faktike të shërbimit sipas udhëzimit të veçantë të Ministrit të Mbrojtjes.
- Specialisti i financës: bazuar në të dhënat e kolonave “b”, “c”, “d”, “e” të plotësuara nga specialisti i personelit, fillon plotësimin e Modularit nr. 03;
- Në kolonën “**f**” “Paga referuese neto për grade apo funksion në ditë” do të vendoset paga referuese në momentin lindjes së të drejtës për përfitim të pensionit suplementar sipas ligjit, për një ditë e cila është e barabartë me pagën referuese me të gjitha shtesat në momentin lindjes së të drejtës pjesëtuar me 30 ditë. Të dhënat e kolonës “f” në modularin Nr. 03 do të plotësohen dhe do të merren nga të dhënat e kolonës “H”(H=G/30) të modularit Nr. 03/b.

- Në kolonën **g** "Shuma e pagës referuese mujore neto për ditët e funksionit" do të vendoset produkti midis kolonës "e" me kolonën "f".
- Në rreshtin "Shuma" plotësohet shuma e kollones "e" dhe "g" nga rreshti i pare deri tek rreshti i fundit, ku është shënuar funksioni i fundit që ushtaraku ka ndërprerë karrierën.
- Në rreshtin "Paga mesatare referuese neto" do të vendoset kolona "g" që del si rezultat i raportit të shumës së rreshtit "Paga mesatare referuese neto" të kollonës "g" dhe të kolones "e" dhe ajo që del shumëzohet me 30 ditë.

b. Modularin nr. 02 "Vërtetim për pagën referuese neto për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare", plotësohet nga specialisti i financës dhe shoqëron dokumentacioni e përfituesit. Ky modular bashkë me modularin nr .04, janë dokumentet bazë që dërgohen në DRSSH për përfituesit sipas nenit 21, të ligjit nr. 10142, date 15.05.2009.

c. Modular nr. 05 "Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara sipas muajve në strukturën nga ka dalë në rezervë/lirim. Plotësohet nga strukturat e financës së repartit në rastet e trajtimi me pension suplementar të ushtarakëve, të cilët gjatë periudhës që kanë qenë aktiv, kanë paguar sigurimin suplementar.

2. Për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 7496, date 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura" dhe janë në pension të plotë pleqërie dhe që ju lind e drejta për përfitim në datën 27.6.2009, datë e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 10142, datë 15.5.2009 dhe për llogaritjen e pagës referuese neto do të jetë paga e ushtarakut në atë gradë a funksion në datë 27.06.2009.

Strukturat përkatëse do të plotësojnë Modularin 03 dhe 03/b si në paragrafin 1 pika a të këtij kreu, duke ju referuar VKM Nr. 839, date 11.12.2003 "Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

3. Për ri-llogaritjen e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të pensionit suplementar të pleqërisë, të pensionit suplementar të invaliditetit, të pensionit suplementar familjar, që janë caktuar sipas Ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 do të ndiqet kjo procedurë:

a. Vjetërsia në shërbim për kategoritë e përmendura më lart, do të jetë ajo e njohur sipas Ligjit Nr. 8087, datë 13.03.1996 (pika B 1 dhe 5 e kreut të V-të të VKM-së Nr. 793, datë 24.9.2010).

- Plotësohet Modulari Nr. 03 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto" dhe Modularin Nr. 03/a "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën" për të gjithë ata që e drejta për përfitim u ka lindur para datës 01.01.2004. Llogaritja e pagës është e njëjtë me atë të shpjeguar në paragrafin 1 pika a të këtij kreu, me ndryshimin që të dhënat e kolonës "f" në Modularin

- Në kolonën g "Shuma e pagës referuese mujore neto për ditët e funksionit" do të vendoset produkti midis kolonës "e" me kolonën "f".
- Në rreshtin "Shuma" plotësohet shuma e kollones "e" dhe "g" nga rreshti i pare deri tek rreshti i fundit, ku është shënuar funksioni i fundit që ushtaraku ka ndërprerë karrierën.
- Në rreshtin "Paga mesatare referuese neto" do të vendoset kolona "g" që del si rezultat i raportit të shumës së rreshtit "Paga mesatare referuese neto" të kollonës "g" dhe të kolones "e" dhe ajo që del shumëzohet me 30 ditë.

b. Modularin nr. 02 "Vërtetim për pagën referuese neto për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare", plotësohet nga specialisti i financës dhe shoqëron dokumentacioni e përfituesit. Ky modular bashkë me modularin nr .04, janë dokumentet bazë që dërgohen në DRSSH për përfituesit sipas nenit 21, të ligjit nr. 10142, date 15.05.2009.

c. Modular nr. 05 "Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara sipas muajve në strukturën nga ka dalë në rezervë/lirim. Plotësohet nga strukturat e financës së repartit në rastet e trajtimi me pension suplementar të ushtarakëve, të cilët gjatë periudhës që kanë qenë aktiv, kanë paguar sigurimin suplementar.

2. Për ushtarakët që kanë ndërprerë karrierën përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 7496, date 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura" dhe janë në pension të plotë pleqërie dhe që ju lind e drejta për përfitim në datën 27.6.2009, datë e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 10142, datë 15.5.2009 dhe për llogaritjen e pagës referuese neto do të jetë paga e ushtarakut në atë gradë a funksion në datë 27.06.2009. Strukturat përkatëse do të plotësojnë Modularin 03 dhe 03/b si në paragrafin 1 pika a të këtij kreu, duke ju referuar VKM Nr. 839, date 11.12.2003 "Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

3. Për ri-llogaritjen e pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të pensionit suplementar të pleqërisë, të pensionit suplementar të invaliditetit, të pensionit suplementar familjar, që janë caktuar sipas Ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 do të ndiqet kjo procedurë:

a. Vjetërsia në shërbim për kategoritë e përmendura më lart, do të jetë ajo e njohur sipas Ligjit Nr. 8087, datë 13.03.1996 (pika B 1 dhe 5 e kreut të V-të të VKM-së Nr. 793, datë 24.9.2010).

- Plotësohet Modulari Nr. 03 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto" dhe Modularin Nr. 03/a "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën" për të gjithë ata që e drejta për përfitim u ka lindur para datës 01.01.2004. Llogaritja e pagës është e njëjtë me atë të shpjeguar në paragrafin 1 pika a të këtij kreu, me ndryshimin që të dhënat e kolonës "f" në Modularin

Nr. 03 do të plotësohen dhe do të merren nga të dhënat e kolonës "J" të Modularit Nr. 03/a.

- o Plotësohet Modulari Nr. 03 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare referuese" dhe Modularin Nr. 03/b "paga referuese mesatare për të gjithë karrierën", për të gjithë ata që e drejta për përfitim u ka lindur mbas datës 01.01.2004.
- o Përfituesve të cilëve e drejta për të përfituar i ka lindur para datës 1.1.1999, paga referuese për secilin funksion (të dhënat e kolonave "D", "E", "F", "G", "H" të Modularit Nr.3/a) do të jetë paga dhe shtesat që janë zbatuar për atë funksion në datë 1.1.1999.
- o Përfituesve të cilëve e drejta për të përfituar i ka lindur nga data 1.1.1999 deri në 31.12.2003, paga mujore referuese për secilin funksion (të dhënat e kolonave "D", "E", "F", "G", "H" të Modularit Nr.3/a) do të jetë paga dhe shtesat që janë zbatuar për atë funksion nga data 1.1.1999 deri 31.12.2003, sipas datës së lindjes së të drejtës.
- o Përfituesve të cilëve e drejta për të përfituar i ka lindur mbas datës 1.1.2004 (duke përfshirë dhe këtë datë), të dhënat e kolonave "D", "E", "F" të Modularit Nr.3/b do të jenë pagat dhe shtesat që janë zbatuar për ato grada dhe funksione nga data 1.1.2004 e në vazhdim, sipas datës së lindjes së të drejtës.

- b. Modulari 03 i plotësuar si më sipër i përcillet strukturës rajonale të sigurimeve shoqërore që ka iniciuar procedurën e ri-llogaritjes me postë të shoqëruar me shkresë përcjellëse

VI. Llojet e dokumentacioneve që dërgohen nga strukturat e vartësise në komandën e forces, njesisë apo reparteve ushtarake dhe ato që arkivohen në sekretarite(dosjet personale) e tyre.

1. Strukturat vartëse dërgojnë në strukturat eprorë, me shkresë përcjellëse dhe rrugë zyrtare, dokumentacionin e dosjes së përfituesit sipas llojit të përfitimit si më poshte:

- a. Për ushtarakun që përfiton pension suplementar të parakohshëm për vjetërsi shërbimi:
 - Kopje të kërkesës personale që është plotësuar nga ushtaraku në komandën e repartit(modular tip).
 - Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (modulari nr.01).
 - fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose çertifikatë personale me fotografi.
 - Vërtetim për periudhën e shërbimit dhe pagën mesatare referuese neto (modulari nr.03).
 - Modulari 03/b "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën"
 - Vërtetim i pagës referuese neto të gradës ose të funksionit më të fundit(modular nr.02).

- Vërtetim tip të trajtimit me pagesë kalimtare.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve (modular nr.05).

b. Për të përfituar pension suplementar pleqërie.

- Kopje të kërkesës personale që është plotësuar nga ushtaraku në komandën e repartit (modular tip);
- Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (modulari nr.01);
- Fotokopje të letërnjoftimit elektronik të firmosur nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit dhe pagën mesatare referuese neto (modulari nr.03);
- Modulari 03/b "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën"
- Vërtetim i pagës referuese neto të gradës ose të funksionit më të fundit(modular nr.02).
- Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve (modular nr. 05).

c. Për të përfituar pension suplementar invaliditeti :

- Kopje të kërkesës personale që është plotësuar nga ushtaraku në komandën e repartit (Modular tip);
- Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (Modulari nr.01);
- Fotokopje të letërnjoftimit elektronik të firmosur nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit dhe pagën mesatare referuese (modulari nr.03);
- Modulari 03/b "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën"
- Vërtetim i pagës referuese neto të gradës ose të funksionit më të fundit(modular nr.02).
- Kopje të Vendim i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
- Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve(modular nr.05);

d. Për të përfituar pension suplementar familjar:

- Kopje të kërkesës personale që është plotësuar nga ushtaraku në komandën e repartit(Modular tip);
- Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve Shoqërore (Modular nr.01);
- Certifikatë familjare;
- Certifikatë vdekjeje;
- Vërtetim për periudhën e shërbimit dhe pagën mesatare referuese

- neto(modulari nr.03);
 - Vërtetim i pagës referuse neto të gradës ose të funksionit më të fundit(modular nr.02).
 - Modular 03/b "Paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën
 - Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve (Modular Nr.05);
- e. Për të përfituar pension suplementar familjar, në rastet kur personat kanë humbur jetën në detyrë dhe për shkak të saj:
- Kopje të kërkesës personale që është plotësuar nga antari i familjes së ushtaraku në komandën e repartit(modular tip);
 - Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (modulari nr.01);
 - certifikatë familjare;
 - certifikatë vdekjeje;
 - Vërtetim për vjetërsinë e punës e shërbimit për efekt të përfitimeve nga sigurimi suplementar (modulari 04);
 - Vërtetim i pagës referuse neto të gradës ose të funksionit më të fundit(modular nr.02).
2. Në komandën e repartit (në dosjen personale) do të qendrojnë këto dokumenta:
- Një kopje të kërkesës personale të ushtarakut apo familjes së ushtarakut që është plotësuar në komandën e repartit (modulari tip);
 - Një kopje të Vërtetimit për periudhën e shërbimit dhe pagën mesatare Referues neto(modulari nr. 03);
 - Modulari 03/b "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën"
 - Modulari 03/a "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën" për ushtaraket që kanë dale në rezervë ose lirim para datës 01.01.2004.
 - Një kopje të Vërtetimit për vjetërsinë e punës e shërbimit si ushtarak për efekt të përfitimeve nga sigurimi suplementar (modular nr. 04).
 - Një kopje të Vërtetimit të pagës referuese neto të gradës ose të funksionit më të fundit, për familjarët e ushtarakut që ka vdekur në detyrë dhe për shkak të detyrës.(modulari nr. 02);
 - Një kopje Vërtetim për efekt pensioni vjetërsie shërbimi, invaliditeti ose familjar (Modulari tip 31).
 - Një kopje Vërtetim për pagat mesatare të 10 viteve të fundit.
 - Një kopje e vendimit të gjykatës për njohjen e vjetërsisë së shërbimit, në rastin kur nuk disponohet dosja origjinale e n/officerit.

VII. Dokumentacioni që plotësohet dhe dërgohet në strukturat e ISSH nga Drejtoria e Përkujdesjes Sociale në MM, Komandat e forcave, komandat e njesive dhe reparteve ushtarake dhe dokumentacioni që vendoset(ruhet) në dosje.

1. Strukturat përgjegjëse, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të ushtarakut që ndodhet në kartotekën e personelit dhe dokumentet e dërguara nga strukturat vartëse, në përfundim të verifikimit, sipas llojit të përfitimit plotëson në 2(dy) kopje modularin tip dhe pas firmosjes nga titullari përgjegjës, dërgon zyrtarisht nëpërmjet postës zyrtare, në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore ku banon ushtaraku, veç për çdo përfitues të shoqëruar me shkresë përcjellse, një kopje të dokumentave të mëposhtme:

- Vërtetimi për vjetërsinë e punës e shërbimit si ushtarak për efekt të përfitimeve nga sigurimi suplementar (modular nr. 04).
- Vërtetimi për pagën neto referuese për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare (modular nr. 02).
- Vërtetim për vjetërsi në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto(modular nr. 03).
- Vërtetim kronologjik për kontributet suplementare të paguara, sipas muajve (Modular Nr.05);
- Dëshmi penaliteti.

2. Strukturat përgjegjëse që menaxhojnë përgatitjen përfundimtare dhe dërgimin në DRSSH të dokumentacionit të ushtarakut apo familjes së ushtarakut përfitues arkivon në sekretari apo vendos në dosjen personale të ushtarakut dokumentat si më poshtë:

- Një kopje të kërkesës personale të ushtarakut apo familjes së ushtarakut që është plotësuar në komandën e repartit (modelari tip);
- Kopje të kërkesës format të plotësuar në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore (modulari nr.01);
- Fotokopje të letërnjoftimit elektronik të firmosur nga vetë personi ose çertifikatë personale me fotografi.
- çertifikatë familjare;
- çertifikatë familjare;
- Vërtetim për vjetërsi në shërbim dhe pagën mesatare referuese Neto(modular nr.03).
- Modulari 03/b "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën" për ushtarakët që kanë dalë në rezervë ose lirim pas datës 01.01.2004.
- Modulari 03/a "paga referuese mesatare neto për të gjithë karrierën" për ushtarakët që kanë dalë në rezervë ose lirim para datës 01.01.2004.
- Vërtetimin për vjetërsinë e punës e shërbimit si ushtarak për efekt të përfitimeve nga sigurimi suplementar (modular nr. 04).
- Vërtetimin për pagën referuese neto për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare (modular nr.02).

VIII. Drejtoria e Përkujdesjes Sociale në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat përgjegjëse në Forcat e Armatosura, për rastet kur ushtarakët kanë shërbyer në strukturat e ministrive e institucioneve të tjera të përfshira në Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009, brenda afateve ligjore, shkëmbejnë zyrtarisht dokumentacionin

përkatës për plotësimin e periudhës së shërbimit dhe të pagës mesatare referuese neto.

IX. Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (Drejtoria e Përkujdesjes Sociale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (Drejtoria e Finances) në Ministrinë e Mbrojtjes, kontrollojnë periodikisht zbatimin nga strukturat përgjegjëse në FA, të procedurave të plotësimit dhe qarkullimit të dekumentacionit administrativ për përfitimet nga sigurimet shoqërore suplementare.

X. Në MM, SHPFA dhe Komandat e forcave, njërive, reparteve apo drejtoritë e institucioneve ushtarake në vartësi të drejtpërdrejtë të MM dhe SHPFA, bashkëpunojnë dhe ndihmojnë përfaqësuesit të autorizuar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave ligjore, të bëjnë verifikime në dekumentacionin që ka lidhje me përfitimet nga sigurimet shoqërore suplementare.

XI. Udhëzimi i Ministrit të mbrojtjes Nr 4545 datë, 30.12.1999 "Për plotësimin e dekumentacionit të ushtarkëve që do të trajtohen sipas ligjit Nr.8521 datë 30.07.1999, VKM Nr. 579, datë 08.12.1999 dhe përcjellja e tyre në I.S.SH. për efekt të pagesës financiare", shfuqëzohet.

XII. Bashkëngjitur udhëzimit modularët tip që plotësohen nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe ato të Forcave të Armatosura, për plotësimin e dekumentacionit për përfituesit.

XIII. Përgjigjet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare, Komanda e Forcës Ajrore, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Brigadës së Mbështetjes Rajonale, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes, Komanda e Policisë Ushtarake, Komanda e Qendrës së Personel Rekrutimit, Komanda e Agjencisë Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Drejtoria e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak, Drejtoria e Qendrës së Kulturës, Medies dhe Botimeve të Mbrojtjes, Drejtoria e Institutit të Studimeve e Projektmeve të Mbrojtjes dhe Drejtoria e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare.

XIV. Ndjekin zbatimin e udhëzimit Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky udhëzim hynë në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ARBEN IMAMI

